

STATUTI

Sindikata e Sektorit Hidrokarbur (SSH)

Parime të përgjithshme

Emri, Selia, Fusha e Veprimtarisë

Neni 1

Sindikata e Sektorit Hidrokarbur (SSH) është organizatë sindikale qendrore e krijuar mbi bashkimin vullnetar të punonjësve të sektorit hidrokarbur në të gjithë Shqipërinë, që përfshijnë shoqëritë publike dhe private, që lidhen me adiministratat, filialet, zyrat e degët, institutet kërkimore, agjencitë mbikqyrëse, shoqëritë tregtare dhe çdo subjekt tjetër, të cilat lidhen direkt ose indirekt me shoqëritë/subjektet që operojnë në fushën e hidrokarbureve.

Neni 2

Sindikata e Sektorit Hidrokarbur (SSH) ka statutin e saj. Statuti i Sindikates nuk mund të bjerë ndesh me aktet normative ligjore e nënligjore të shtetit shqiptar, me Kartën e të Drejtave të Njeriut dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar.

Neni 3

Sindikata e Sektorit Hidrokarbur (SSH) ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të shtetit shqiptar. SSH është një organizatë sindikale profesionale, shoqërore që përfaqëson interesat në fushat ekonomike dhe sociale të jetës publike dhe shoqërore të anëtarëve të saj, të punëmarrësve të sektorit të sektorit hidrokarbur dhe të punëmarrësve në përgjithsi.

Neni 4

Sindikata e Sektorit Hidrokarbur (SSH) është person juridik.
SSH ka vulën, emblemën dhe flamurin e saj.

Neni 5

Sindikata e Sektorit Hidrokarbur (SSH) është e pavarur, ajo mund të jetë anëtare e federatave dhe konfederatave sindikale. SSH mund të anëtaresohet në organizata ndërkombëtare dhe të bashkëpunojë me to.

Neni 6

Selia e Sindikates është e vendosur në: Rruga Fier-Patos km. 7, Patos.

Neni 7

Sindikata e Sektorit Hidrokarbur (SSH) është bashkim i organizatave dhe këshillave sindikale sipas strukture organizative të saj të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Sindikatës.

Neni 8

Sindikata e Sektorit Hidrokarbur (SSH) shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Sindikata bashkëpunon dhe koordinon veprimtarinë e saj me të gjitha organizatat sindikale demokratike si brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Neni 9

Sindikata e Sektorit Hidrokarbur (SSH), në rang ndërkombëtar mund të jetë anëtare e Sekretariateve Ndërkombëtare, dhe në Sekretariatet perkatëse europiane. Ajo është e hapur për bashkëpunim dhe gëzon të drejtën e pranimit në strukturat sindikaliste demokratike ndërkombëtare.

Objektivat dhe qëllimet e sindikatës

Neni 10

Sindikata e Sektorit Hidrokarbur (SSH) zhvillon veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga partitë politike, organet shtetërore dhe çdo organizatë apo grupim tjetër politik a shoqëror. Ajo nuk jep llogari dhe nuk kontrollohet prej tyre, për aq sa parashikohet në këtë statut.

Neni 11

Sindikata lufton për të mbrojtur parimet bazë të demokracisë në shtet, në ekonomi dhe në shoqëri. Mbrojtja e këtyre parimeve bazë kërkon edhe përdorimin e të drejtës së rezistencës demokratike.

Neni 12

Sindikata e Sektorit Hidrokarbur ka për qëllim mbrojtjen e interesave të përbashkëta të punëmarrësve në Sektorin Hidrokarbur dhe të punonjësve në përgjithësi, me qëllim arritjen e standardeve optimale të mirëqënies, të drejta të barabarta në punë për burrat dhe gratë, mundësi e shanse të barabarta për të gjitha shtresat dhe grupet moshore, për siguri e shëndet në punë, për paga dinjitoze dhe për të siguruar një mbrojtje mjedisore në përputhje me standartet e gjithëpranuara të anëtarëve të saj.

Neni 13

Sindikata e Sektorit Hidrokarbur përfaqëson e mbron drejtpërdrejtë interesat dhe të drejtat e anëtarëve të saj përpara institucioneve shtetërore apo subjekteve private, si dhe në raport me tre pushtetet: legjislativin, ekzekutiv dhe gjyqësor, në:

- Mbrojtjen dhe garantimin e të drejtës së punës;
- Sigurimi i pagës dhe shpërblimeve të tjera;
- Ulja e kohës së punës dhe garantimi i kushteve thelbësore të sigurisë në punë;

- Sigurimi i një mbrojtjeje ligjore duke' garantuar mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të punonjësve;
- Ruajtja e shëndetit dhe mirëqënies së punonjësve;
- Zbatimi rigoroz i rregullave të sigurimit teknik në punë;
- Ngritja e nivelit arsimor dhe kualifikimit perofesional;
- Mbrojtja e anëtarëve nga veprimet burokratike, spekulative e abuzimeve me të miturit dhe gratë;
- Sigurimin e kontraktimit kolektiv dhe një mbrojtje kolektive ndaj punëdhënësit duke garantuar negociim e zhvillim dialogu dy e tri palësht në të gjitha nivelet.
- Zbatimi i të drejtës në sindikatë për të marrë pjesë në drejtimin dhe administrimin e prodhimit, shpërndarjen e fitimit, zgjidhjen e problemeve sociale,
- Përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore,
- Mbrojtja nga largimet e padrejta nga puna.
- Forcimi i unitetit e prosperitetit demokratik kombëtar.
- Forcimi i solidaritetit ndërkombëtar,
- Të gjitha këto arrihen me përpjekje dhe arritjen e marrëveshjeve kolektive të të gjitha niveleve, sigurimin e një aktiviteti të plotë demokratik e pluralist në vepimtarinë e sindikatës. Organizimin e bisedave, takimeve, mbledhjeve, tubimeve, protestave demokratike e deri tek greva.

Neni 14 **Anëtarësimi**

Anëtarësimi në Sindikatën e Sektorit Hidrokarbur është vullnetar.

Të gjithë anëtarët e sindikatës janë të barabartë pavarësisht nga gjinia, nacionaliteti, feja, idea apo anëtarësimi partiak apo grupimi tjetër politik e ligjor.

Neni 15

Sapo pranohet çdo anëtar pajiset ne kartën e anëtarësisë e cila përmban shenjën dalluese të sindikatës, identitetin e numrin personal të anëtarit, emrin dhe selinë e organizatës që e lëshon.

Anëtar i që largohet nga sindikata, është i detyruar të kthejë kartën e anëtarësisë. Kur kjo kartë humbet njoftohet kryesia e Sindikates, e cila e shpall atë të pavlefshme.

Neni 16

Në rastet e largimit me dëshirë si dhe ripranimin në ndonjë sindikatë tjetër, anëtar i që largohet duhet t'i shlyejë sindikatës detyrimet statutore dhe financiare deri në fund të vitit kalendarik.

Neni 17

Anëtarësia në organizatat sindikale vërtetohet në bazë të regjistrimit të anëtarëve në librin e posaçëm që hartohet nga Sindikata, seksionet sindikale si dhe nga kërkesat e pranimit, deklarimet e aderimit personal të çdo anëtarit, apo nga listat e anëtarësisë të nënshkruara nga secili anëtar. Në këtë rast lista duhet të ketë si logo stemën e Sindikates.

Neni 18

Organet drejtuese të Sindikatës

Organi më i lartë i Sindikates është Kongresi, ndërsa në periudhën midis dy kongreseve është Këshilli Kombëtar.

Norma e përfaqësimit në Kongres është: 50 anëtarë përfaqësohen nga 1 delegat. Mandati i tyre është 5-vjeçar. Kongresi zakonisht mbledhet çdo 5 vjet. Kongresi mund të mbledhet me kërkesën e 3/5 të anetareve të Këshillit Kombëtar të sindikatës.

Në çdo kohë, kur gjykohet se ka shkaqe të arsyeshme, me kërkesën me shkrim të 3/5 të delegatëve të mandatuar nga kongresi, ose me kërkesën e 3/5 të anetareve të Këshillit Kombëtar të SSH, mund të mbledhet kongresi i jashtëzakonshëm i Sindikates.

Delegatët e Kongresit zgjidhen nga Asambleja e përgjithshme e organizatave sindikale të ndërmarrjeve, rretheve e rajoneve apo nga asambleja e përgjithshme të seksioneve sindikale që aderojnë në sindikatë.

Rendi i ditës dhe data e Kongresit shpallen jo më vonë se 30 dite përpara mbajtjes së tij.

Neni 19

Kongresi shqyrton veprimtarinë e Sindikates e të organeve të saj dhe miraton programin e drejtimit e punës së Sindikates për periudhën 5-vjeçare. Miraton Satutin e Sindikates apo ndryshimet që i bëhen atij. Zgjedh organet drejtuese, Kryetarin, miraton strukturën e Këshillit Kombëtar, Komisionin e financës dhe auditimit, Komisionin e Gjyimit Disiplinor, Komisionin e Statutit.

Neni 20

Këshilli Kombëtar

Këshilli Kombëtar është organi që drejton veprimtarinë e Sindikates midis dy Kongreseve. Këshilli Kombëtar përbëhet nga të gjithë Kryetarët e organizatave sindikale të seksioneve sindikale në ndërmarrjet publike e private, si dhe nga Kryetarët e ndërmarrjes/degës/subjektit që përbëjnë Sindikaten, nga Kordinatorët e rjetit të gruas dhe të rjetit të rinjeve të Sindikates.

Neni 21

Në mbledhjen e parë pas Kongresit, konstituohet Këshilli Kombëtar, i cila zgjedh dy zv/Kryetar dhe Sekretarin Organizativ si dhe ratifikon Kryesinë e Sindikatës.

Neni 22

Këshilli Kombëtar përfaqëson të gjithë organizatat anëtare, këshillat sindikale të ndërmarrjes/degës/subjektit në raport me punëdhënësin dhe ndjek zgjidhjen e problemeve që ngrihen prej tyre. Përcakton drejtimet dhe problemet kryesore të aktmarrëveshjeve, paketave e kontratave kolektive që lidhen midis Sindikates dhe punëdhënësve apo Qeverisë. Mbështet veprimtarinë e organizatave anëtare, organizon mitingje e manifestime, përdor mjetet e informacionit masiv e forma të tjera demokratike për të propaganduar dhe arritur qëllimet e saj.

Neni 23

Këshilli kombëtar vendos për organizimin e grevës së plotë ose të pjesshme në shkallë dege ose kombëtare si dhe të gjithë metodave të njohura të rezistencës demokratike paqësore. Këto vendime miratohen me votat e 3/5 të anëtarëve të Këshillit Kombëtar

Neni 24

Këshilli Kombëtar propozon pranë organeve kompetente përmirësimet dhe ndryshimet e nevojshme në sferën e legjislacionit. Miratton buxhetin vjetor të Sindikates, përcakton burimet e të ardhurave financiare dhe zërat e shpenzimeve. Vendosi për fondin e garantimit, grevës, solidaritetit etj. U jep këshillave sindikale, seksioneve sindikale të ndërmarrjes/degës/subjektit ndihmën e nevojshme për çështje metodike, organizative, juridike, kualifikuese dhe organizon punën për përgatitjen dhe aftësimin e anëtarëve të zgjedhur me këshillat sindikale. Vendosi strukturën, numrin e punonjësve të aparatit të administratës së Sindikates dhe pagën mujore të drejtuesve të zgjedhur funksionarë të Sindikates.

Neni 25

Këshilli Kombëtar i Sindikates mbledhet jo më pak se dy herë në vit në mbledhje të zakonshme dhe në mbledhje të jashtëzakonshme mbledhet me kërkesën e 1/4 e anëtarëve të saj ose me kërkesën e Kryetarit të Sindikates. Vendimet e Këshilli Kombëtar nënshkruhen nga Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes ose vetëm nga sekretari i mbledhjes kur mbledhja thirret nga anëtarët e Këshilli Kombëtar.

Neni 26

Kryesia e Sindikatës

Kryesia e Sindikatës përbëhet nga Kryetari, dy zv/Kryetarët nga sekretari organizativ, Koordinator i rrjetit të trajnimit dhe kualifikimit sindikal, Koordinatorja e rrjetit të gruas, Koordinator i rrjetit të rinjve, Koordinator i bordit ekonomiko-financiar.

Neni 27

Kryesia e Sindikates organizon punën dhe ndjek zbatimin e detyrave të caktuara nga Këshilli Kombëtar i Sindikates dhe Kongresi i Sindikates. Vendosi për datën dhe axhendën e mbledhjes së Këshillit të Sindikates dhe përgatit dokumentat e materialet që do të parashtrihen në mbledhjen e Këshillit të Sindikates.

Neni 28

Kryesia e Sindikates organizon e drejton punën organizative të Sindikates. Ajo ndjek zbatimin e buxhetit dhe të planeve ekonomiko-financiare të Sindikates. Ndjek zbatimin e vendimeve. Vendosi, për përfaqësimin e Sindikates në aktivitetet ndërkombëtare dhe për veprimtarinë e Sindikates në marrëdhëniet me sindikatat e tjera brenda vendit.

Vendimet e Kryesisë merren me konsensus, në mungesë të konsensusit votohet dhe vota e Kryetarit në rast barazim votash ka vlerë të dyfishtë.

Neni 29

Kryetari i Sindikates

Kryetari i Sindikates zgjidhet nga Kongresi.

Kryetari i Sindikates drejton dhe menaxhon të gjithë aktivitetin e Sindikatës, për aq sa përcaktohet në këtë statut. Ai përfaqëson sindikatën me të tretët, ka përgjegjësinë kryesore për veprimtarinë e

Sindikates në shkallë kombëtare e ndërkombëtare. Përfaqëson Sindikaten në veprimtaritë me organet shtetërore e organizatat shoqërore e joqeveritare, entet private dhe mjetet e propagandës e informacionit brenda e jashtë vendit si dhe në veprimtaritë e marrëdhëniet ndërkombëtare.

Neni 30

Nënshkruan në emër të Sindikates: marrëveshjet, paktet e kontratat me institucionet shtetërore e punëdhënësin privat në shkallë profesioni si dhe deklarata e marrëveshje të ndryshme të karakterit rajonal, kombëtar apo ndërkombëtar. Përfaqëson Sindikaten në strukturat e dialogut social dy e tripalësh në të gjitha nivelet.

Neni 31

Kryetari i Sindikates mban qëndrim dhe merr vendime për çështje që nuk presin, duke vënë në dijeni në mbledhjen më të afërt të Kryesisë dhe Këshillit sipas kompetencave statutore. Drejton mbledhjen e Kryesisë e të Këshillit të Sindikates dhe nënshkruan vendimet që merren në emër të tyre për aq sa parashikohet në këtë statut.

Ne rastet kur mbledhjet e Këshillit të Sindikates dhe kongresi thirren apo legjitimohen nga anëtarët e Këshillit, vendimet që keto marrin nënshkruhen nga sekretari i mbledhjes dhe një përfaqësues i Këshillit sipas vendimit të këshillit.

Neni 32

Kryetari i Sindikates drejton problemet që lidhen me politikën e Sindikates në marrëdhënie me organizatat e tjera brenda vendit si dhe organizatat sindikale ndërkombëtare. Me kërkesën e 1/4 të anëtarëve të Këshillit të Sindikates thërret mbledhjen e jashtë radhes së Këshillit brenda 30 ditëve.

Neni 33

Sekretari Organizativ i Sindikates

Sekretari Organizativ i Sindikates, me propozim të Kryetarit të Sindikatës zgjidhet nga Këshilli Kombëtar i Sindikatës, organizon dhe menaxhon gjithë veprimtarinë ekzekutive të Sindikates në përputhje me detyrat që i ngarkon Kryesia si dhe Kryetari i Sindikates.

Neni 34

Seksioni sindikal i ndërmarrjes/degës/subjektit

Sindikata e Sektorit Hidrokarbur është bashkimi i seksioneve dhe organizatave sindikale kryesore, punonjësit e të cilave grupohen në seksione në bazë të ndërmarrjes/degës/subjektit sipas ndarjes që bënë Këshilli Kombëtar i Sindikates. Gjithashtu punonjësit grupohen edhe në seksione në bazë profesioni ose nënprofesioni sipas ndarjes që bënë Këshilli Kombëtar.

Neni 35

Anëtarë i seksionit sindikal ndërmarrjes/degës/subjektit është çdo sekretar sindikal i ndërmarrjes shtetërore apo private.

Seksioni sindikal i degës së profesionit zgjedh sekretarin rajonal të degës së profesionit dhe dy zv/sekretarë.

Neni 36

Seksioni sindikal i degës së profesionit mbledhet sipas problematikës dhe nevojave por jo më rrallë se 6 muaj. Nuk është strukturë vendimarrëse por konsultative. Të gjitha vendimet e tij ratifikohen dhe marrin fuqi vendimore në Këshillin Kombëtar të Sindikates.

Organizata sindikale bazë

Organizata sindikale është bashkimi i punëtorëve në ndërmarrje, filiale, institucione në sektorin publik e privat. Anëtar i saj do të jetë çdo punonjës, i cili ka plotësuar dhe i është miratuar kërkesa e pranimit si anëtar i Sindikates.

Neni 37

Anëtari detyrohet të zbatojë Statutin, programin e Sindikates si dhe të paguajë kuotazicionin e të marrë pjesë aktivisht në mbledhjet dhe aktivitetet e Sindikates në përputhje me Statutin, rregulloren dhe programin e saj.

Neni 38

Forumi më i lartë i organizatës sindikale në bazë është mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të anëtarëve e cila diskuton veprimtarinë e organizatës sindikale dhe përcakton drejtimin e punës për të ardhmen. Ajo zgjedh delegatët për Kongresin e Sindikates në përputhje me udhëzimet e Këshillit Kombëtar të Sindikates.

Organi drejtues i organizatës bazë sindikale është Këshilli Sindikal i Bazës i cili zgjedh sekretarin dhe zëvendësin e tij. Këshilli Sindikal i organizatës bazë zgjidhet me normë përfaqësimi sipas një rregulloreje që miraton Këshilli Kombëtar i Sindikates.

Neni 39

Këshilli Sindikal i bazës me shumicë votash bën revokimin e të zgjedhurve kur ata thyejnë dhe nuk zbatojnë normat e Statutit, prishin unitetin ose mundohen të venë nën ndikime personale apo partiake veprimtarinë e sindikatës.

Neni 40

Këshilli Sindikal i bazës, ndjek zbatimin e kontratave kolektive, zhvillon bisedime të hapura me drejtuesit e sektorit. Ka të drejtë të përdorë dhe grevën lokale si mjet për arritjen e qëllimeve sindikaliste. Mban lidhje me seksionet e rrethit apo qarkut, me seksionet e degës së profesionit si dhe me Sindikaten, informon, ju ngre probleme dhe ju kërkon ndihmë për zgjidhjen e drejtë të tyre.

Neni 41

Këshilli Sindikal i bazës ndjek zbatimin e vendimeve të forumeve të Sindikates, i raporton asaj për ndryshimet në efektivin e anëtarësisë së sindikatës, plotëson dhe mban librin e anëtarësisë së organizatës si dhe gjithë dokumentacionin e përcaktuar me rregullore nga Këshilli i Sindikates.



Neni 42

Këshilli Sindikal i bazës koordinon dhe rakordon aktivitetin sindikal me Këshillin dhe Sekretarin Rajonal në njësinë ku ushtron aktivitetin. Jep llogari për veprimtarinë e tij në mbledhjen e përgjithshme të organizatës sindikale. Organizon mbledhjen e rregullt të kuotave të anëtarësisë së sindikatës sipas statutit të Sindikates.

Neni 43

Komisioni i Gjykimit Disiplinor

Kongresi i rregullt i Sindikates zgjedh strukturën e Komisionit të Gjykimit Disiplinor. Ky Komision ka për detyrë:

Për të zgjidhur demokratikisht mosmarrëveshjet dhe për të gjykuar e ndëshkuar ata anëtarë që shkelin Statutin dhe rregulloren e Sindikates.

Neni 44

Komisioni i Gjykimit Disiplinor përbëhet nga 3 (tre) anëtarë. Anëtari i këtij komisioni duhet të ketë një vjetërsi në sindikatë prej mbi 3 vjet. Mundësisht të jenë ekspertë dhe me reputacion në sindikatë. Ata duhet të jenë të zgjedhur në strukturat kombëtare të sindikatës. Njëri nga anëtarët zgjidhet nga komisioni si Sekretar i tij. Ata nuk duhet të kenë lidhje direkte me gjykimet në fjalë. Në këto raste anëtari që ka lidhje me të gjykuarin neutralizohet përkohësisht nga Komisioni.

Neni 45

Komisioni i Gjykimit Disiplinor shqyrton dhe merr vendimet kolegjalisht.

Neni 46

Komisioni i Gjykimit Disiplinor merr këto masa:

- Shfajësimin e anëtarit të akuzuar.
- Pezullim të kufizuar nga funksionet sindikale si dhe nga delegacionet e sindikatës.
- Përfjashtim nga sindikata.
- Vendimi merret me shkrim dhe i paraqitet palëve të interesuara dhe Këshillit i cila në mbledhjen e radhës e diskuton. Vendimi i Këshillit është final. I fajësuar ka të drejtë t'i drejtohet dhe Kongresit, vendimi i së cilës është i formës së prerë.

Neni 47

Mospranimi dhe pacënueshmëria e zgjedhjeve

Brenda 10 ditësh nga kryerja e tyre zgjedhjet mund të kundërshtohen. Deklarimi i mospranimit duhet të bëhet me shkrim duke treguar arsyet e kundërshtimit. Të autorizuar për të kundërshtuar zgjedhjet janë:

- 1/4 e njerëzve të lejuar për të votuar në zgjedhjet që janë kundërshtuar.
- I deleguari për të ndjekur zgjedhjet ose anëtari i Këshillit që bën pjesë në njësinë qendrore.

Raporti i tij/tyre paraqitet në Këshillin Kombëtar i cili vendos.

Neni 48

Mospranimi zgjedhjeve pranohet nëse një e metë që është zbuluar ka ndikuar direkt në rezultatin e zgjedhjeve

Organi më i lartë statutor brenda 10 ditëve merr vendim dhe i kthen përgjigje me shkrim të ankuarve për vlefshmërinë e zgjedhjeve.

Neni 49

Komisioni i Financës dhe Auditimit

Kongresi i rregullt i Sindikates së Sektorit Hidrokarbur zgjedh strukturën e komisionit prej 3 (tre) anëtarë për të ndjekur dhe kontrolluar problemet financiare të sindikatës. Ky komision zgjedh një sekretar dhe një zv/sekretar. Komisioni i Financës dhe Auditimit është i detyruar të revizionojë dhe certifikojë llogarinë e Sindikates.

Neni 50

Komisioni i Financës dhe Auditimit ka për detyrë të kontrollojë zbatimin e buxhetit, përdorimin e drejtë të mjeteve financiare e monetare, përmbajtjen dhe mirëmenaxhimin e pasurisë së sindikatës. Komisioni ushtron kontroll në Forumet e Sindikatës për zgjidhjen e kërkesave dhe ankesave të anëtarëve dhe zbatueshmërinë e plotë statutore.

Neni 51

Revizionimi i llogarive si dhe çdo vendim tjetër i këtij Komisioni mbahet me proceverbal me shkrim i cili dorëzohet në Kryesinë e Sindikates një kopje. Ky Komision raporton një herë në vit në Këshill dhe në çdo Kongres raporton për aktivitetin e tij 5-vjeçar. Anëtarët e Komisionit japin llogari para anëtarëve të sindikatës dhe forumeve që i ka zgjedhur.

Neni 52

Komisioni i Statutit

Kongresi i rregullt i Sindikates zgjedh strukturën e Komisionit të Statutit. Ky komision perbehet nga 3 (tre) anëtar. Komisioni zgjedh sekretarin dhe zv/sekretarin dhe miraton rregullat e procedurën e punës së tij.

Neni 53

Komisioni i Statutit kryen studime dhe konsultime për përmirësimet e nevojshme në Statut dhe i nxjerr rekomandime Kongresit. Ai vendos mbi konfliktet që i përkasin interpretimit të Statutit. Kontrollon direktivat dhe vendimet e strukturave për përputhshmërinë me Statutin dhe raporton në Kongresin e Sindikates.

Neni 54

Shpërndarja dhe Riorganizimi

Sindikata shpërndahet ose riorganizohet kur ka një vendim të formës së prerë të Gjykatës për shpërndarjen e saj, apo një vendim të strukturave vendimarrëse më të larta të saj, i cili është në zbatim të Statutit të Sindikates

Sindikata shpërndahet vetëm me një vendim të Kongresit të Sindikates me 3/5 e votave të delegatëve lejohet të votojnë. Bashkimi me sindikata profesioni të ngjashme nuk konsiderohet shpërndarje. Kongresi i Sindikates vendos për mënyrën e shpërndarjes së anëtarësisë si dhe mbi përdorimin e pasurive të Sindikates.

Shpërndarjen e Sindikates mund ta bëjë vetëm Kongresi i zakonshëm.

Neni 55
Rrjeti i Grave

Rrjeti i grave është pjesë e punës së përgjithshme të Sindikatës së Sektorit Hidrokarbur. Përfaqësimi i interesave të grave në fushat ekonomiko-sociale, profesionale, kulturore e shëndetësore, mbështetet e nxitet nga SSH duke ngritur pranë saj një rrjet të veçantë për gratë.

Neni 56

Koordinatorja e rrjetit të grave është anëtare e Kryesisë së Sindikates. Ajo zgjidhet nga Këshilli kombëtar i Sindikates me propozim të Kryetarit të Sindikates.

Neni 57
Rrjeti i rinisë

Rrjeti i të rinjve është pjesë e punës së përgjithshme të SSH. Përfaqësimi i interesave ekonomiko-sociale, profesionale, kulturore, sportive, arsimore, edukative, të punësimit etj, mbështeten e nxiten nga SSH duke ngritur pranë strukturave të saj një rrjet të veçantë për rininë.

Neni 58

Koordinatori i rrjetit të të rinjve është anëtar i Kryesisë së Sindikates. Ai zgjidhet nga Këshilli Kombëtar i Sindikates me propozim të Kryetarit të Sindikates. Ai koordinon aktivitetin me rrjetin e të rinjve të KSSH-së.

Neni 59
Rrjeti i Trajnimit dhe Kualifikimit Sindikal

Rrjeti i Trajnimit dhe Kualifikimit Sindikal është pjesë e punës së përgjithshme të SSH. Trajnimet, kualifikimet e SSH kryhen me ndihmën dhe asistencën e organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare. Koordinator i rrjetit të trajnimit dhe kualifikimit Sindikal zgjidhet nga Këshilli Kombëtar i Sindikatës me propozim të Kryetarit të Sindikatës.

Neni 60

Të ardhurat nga pasuritë e SSH duhet të përdoren me transparencë të plotë me rregull dhe me kujdes në shërbim të anëtarëve të saj dhe në përputhje me Statutin.

Administrimi i të ardhurave bëhet nga bordi i menaxhimit të aseteve të Sindikates. Bordin e menaxhimit të aseteve e cakton Kryesia e Sindikates.

Neni 61
Veprimtaria botuese

Sindikata nxjerr organin e saj periodik të shtypit. Botimi bëhet në Krysinë e Sindikatës dhe shpërndahet falas tek të gjithë anëtarët e saj.

Neni 62

Kuota e anëtarësisë

Financimi kryesor i Sindikates bëhet nga kuotat e anëtarësisë. Kuotizacioni i anëtarësisë së Sindikates është nga 100 lekë deri në 0,5 – 1 % të pagës bruto, në përputhje me vendimet që merr Kryesia dhe Këshilli Kombëtar vjetor. Çdo anëtar është i lirë të paguajë dhe më shumë se niveli 1 % i pagës bruto.

Neni 63

Çdo anëtar është i detyruar të paguajë kuotat e anëtarësisë. Si rregull kuotat do të mbliidhen me anë të metodave bankare. Për metodën e grumbullimit vendos Kryesia e Sindikatës me udhëzime të veçanta.

Neni 64

Kryesia në buxhetin e çdo viti miraton shpërndarjen e të ardhurave nga kuotat sipas strukturave vertikale si dhe për pagesën e detyrimeve sipas Statutit të saj dhe vendimeve të Këshillit Kombëtar. Pagan kuotat e anëtarësisë në organizmat ndërkombëtare e financime të tjera staturore.

Neni 65

Dispozita të veçanta

Organet e zgjedhura të sindikatës nga qendra në bazë janë persona juridikë me status të posaçëm ligjor me të gjithë të drejtat dhe detyrat që burojnë nga “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” si dhe gjithë legjislacioni shqiptar e Konventat Ndërkombëtare të pranuara nga Republika e Shqipërisë.

Organet drejtuese të Sindikates në perjudhat midis kongreseve zgjidhen në mënyrë demokratike nga poshtë lartë, japin llogari para zgjedhësve dhe janë të revokueshme përpara tyre në çdo kohë.

Neni 66

Drejtuesit e Organizatave dhe Sindikatave vendore dhe Rajonale nuk mund të lëvizin nga puna apo të shkurtohen pa marrë miratimin e Strukturave Sindikale që i kanë zgjedhur.

Neni 67

Të zgjedhurit në organet drejtuese të Sindikates dhe të forumeve drejtuese të saj u njihet e drejta për të hyrë pa pengese në ndërmarrje, firma a institucione me qëllim që të kryejnë detyrat që parashikon Statuti dhe programi i Sindikatës.

Neni 68

Të zgjedhurit që janë funksionarë, kur u mbaron mandati dhe nuk e fitojnë më një mandat tjetër, Sindikata, sipas mundësisë, është e detyruar për t'u përpjekur për sistemimin e tyre në punë sipas profesionit të tyre. Nëse kjo është e pamundur, Sindikata duhet të krijojë mundësinë e punësimit të tyre në sindikatë.

Neni 69

Mandati i Kryetarit të Sindikatës është i papajtueshëm (humbet e drejta për ta fituar) kur gjysma e parë e këtij mandati korrespondon me afatin ligjor të mbushjes së moshës për pension.

Neni 70

SSH pushon së ekzistuari në bazë të kriterëve që përcakton ligji dhe në mënyrë me konkrete kur:

- a. Nuk kryen misionin për të cilin është krijuar.
- b. Me vendim të Kongresit të zakonshëm
- c. Ka një vendim gjyqësor të formes së prerë për shpërndarjen e saj
- d. Në cdo rast tjetër të parashikuar në ligj.

Neni 71

Statuti ka marrë fuqi ligjore për t'u zbatuar që nga data 05.08.2022 pas miratimit të tij në Mbledhjen Themeluese (Kongresin) të "Sindikatës së Sektorit Hidrokarbur".

KRYETARI I SINDIKATËS

Dritan SHAHU

Dritan Shahu

